

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS , në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar i kolegjit, Albert Zogaj dhe Nora Bllaca-Dula anëtarë, në çështjen juridiko-civile të paditësit R. N., nga fshati ... , Komuna e Skenderajt, të cilin me autorizim e përfaqëson B.L., avokat nga Prishtina, Rruga “...” nr. 7, në Prishtinë, kundër të paditurës Drejtorati për Arsim Komuna e Skenderajt, të cilën e përfaqëson Avokati Publik Komunal, F.S., për pagesën e pagave jubilarë dhe përcjelljes në pension, vlera e kontestit 1.473,12 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, C.nr. 158/2013 të datës 08.05.2014, në seancën e kolegjit e mbajtur me dt. 06.09.2017 mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e autorizuarit të paditësit R.N., nga fshati ..., Komuna e Skenderajt, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj, C.nr. 158/2013 i datës 08.05.2014, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit R.N., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Drejtorati për Arsim-Komuna në Skenderaj, që paditësit të ja paguaj borxhin në shumë prej 1.473,12 €, me kamatë ligjore 8 %, nga data e paraqitjes së paditës e gjerë në pagesën definitive dhe të ja kompensoj shpenzimet procedurale në shumë prej 20 €, të gjitha në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit, për shkaqet ankimore të parashikuara me dispozitën e nenit 181 par.1 pika a), b) dhe c) të LPK, me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar, ose të prishet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe vendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre konform me dispozitat e nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se: paditësi kërkesëpadinë e tij e ka mbështetur në Kontratën Kolektive dhe atë në dispozitat e nenit 43 dhe 44 e cila ka hy në fuqi me datën 01.01.2005, ndërsa vlefshmëria e saj ka qenë deri në 31.12.2007. Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka vërtetuar se paditësi është pensionuar me datën 30.04.2013, pasi që ka mbushur moshën 65 vjeç dhe ka shkuar në pension. Pra, në kohën kur Kontrata Kolektive nuk ka qenë në fuqi, sepse e njëjta nuk është nënshkruar nga palët nënshkruese. Pastaj gjykata i është referuar dispozitave të nenit 4 të Ligjit të Punës, nr.03/L-149 ku është përcaktuar se kategoritë e punonjësve publik të cilët nuk janë pjesë e shërbyesve civil, ndërsa neni 4.1 është përcaktuar se Statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për stafin mësimor dhe në kuptim të nenit 143 dhe 450 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar, drejtë ka vlerësuar se nuk ekziston baza juridike që e paditura të detyrohet që paditësit në emër të dy pagave jubilarë dhe dy pagave për përcjellje në pension, t'ia paguaj shumën e tërësishme 1.473,12 €.

Këtë qëndrim juridik, gjykata e shkallës së dytë e mori për arsye se paditësi vërtetë është pensionuar në bazë të fuqisë ligjore, duke filluar nga data 30.04.2013. Mirëpo, Kontrata e Përgjithshme Kolektive e cila është e lidhur në mes të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Qeverisë së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale) dhe Odës Ekonomike të Kosovës e nënshkruar nga ana e punëmarrësit respektivisht BSP të Kosovës, për Qeverinë e Kosovës si dhe Odës Ekonomike të Kosovës, asnjëherë nuk është zbatuar për punonjësit në Kosovë.

Në bazë të nenit 4 të Ligjit të Punës nr. 03/L-149, është fakt se janë përcaktuar kategoritë e punonjësve publik të cilët nuk janë pjesë e shërbyesve civil, ndërsa në nenin 4.1 të të njëjtit Ligj është përcaktuar se Statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për stafin mësimor etj.. Ndërkaq, në rastin konkret një gjë e tillë nuk ka ndodhur me paditësin e as punëtorët tjerë në Kosovë të pensionuar gjatë kësaj periudhe, sepse siç dihet Kontrata Kolektive e sipër cekur asnjëherë nuk është zbatuar për punonjësit në Kosovë.

Është fakt dhe është thënë se Kontrata Kolektive zbatohet që nga 1 janari 2005, mirëpo Kontrata Kolektive si e tillë nuk është zbatuar në dispozitat e cekura të saj, këtë konstatim e bënë edhe Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimet e saj të cilat i referohen çështjes së pagave jubilarë dhe përcjellëse me rastin e pensionimit.

Paditësi ka fituar të drejtën e pensionit të pleqërisë me datën 30.04.2013, në kohën kur ka qenë në fuqi Rregullorja mbi Pensionet në Kosovë, me të cilën në asnjë nen të saj nuk parashihet pagesa e pagave përcjellëse për shkuarjen në pension, ndërsa në nenin 35 të të njëjtës Rregullore parashikohet se kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me te.

Prandaj, Gjykata e Apelit vlerësoi se aktgjykimi i atakuar nuk është në kundërshtim me dispozitat e Rregullores së përmendur, dhe se paditësi pa të drejtë kërkon pagesën e tillë bazuar në Kontratën e Përgjithshme Kolektive, pasi që kjo kontratë deri më tani për punonjësit në Kosovë nuk është zbatuar.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 195.1 pika d) të LPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr.3650/2014, më datë 06.09.2017

KRYETARI I KOLEGJIT-GJYKATËSI
Gëzim Llulluni